

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit I. A. nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPK-s), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. B. K. nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I.nr. 278/2014 të datës 10 dhjetor të vitit 2014, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik më datën 08 shtator të vitit 2016, mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, të të pandehurit me mbrojtësin e tij në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri I. A. nga babai Sh. dhe nëna B.– e lindur I., i lindur më ... në fshatin R., Komuna e P., tani me vendbanim në Gj., rruga “ ... “ nr. ..., posedues i telefonit mobil me SIM karte ... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tetë fëmijëve madhor, ka të kryer katër vjet të shkollës fillore, pensioner, me gjendje të dobët ekonomike, i pagjykuar, nuk zhvillohet procedure tjetër penale, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore me lëshuarje të urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse në kohë të pavërtetuar më parë deri më datën ..., rreth ores ... minuta, në Gj., në afërsi të varrezave në kundërshtim me ligjin për armët pa autorizim dhe pa leje valide, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi armën e zjarrt – pistoletën “ ... “ me numër serik ... kalibër ...mm, ... fishekë të kalibrit ...mm dhe ... karikator të zbrastë, ashtu që e vë dorën në drez para të miturve H. G. dhe S. R. të cilët më pas njoftojnë Policinë e Kosovës, e që pas kontrollimit personal nga ana e pjestarëve të Policisë e njëjta i gjendet dhe i sekuestrohet,

- me çka ka kryer veprë penale **mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzimin të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK-s.**

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 45, 49-54, 73, 74 dhe 75 të KPRK-s si dhe nenit 365 të Kodit të Procedures Penale (KPP-s) të pandehurit në fjalë,

I SHQIPTON DËNIM ME KUSHT

ashtu që të njëjtit ia cakton **dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve,** duke urdhëruar menjëherë që ky dënim most ë ekzekutohet nëse i pandehuri **në afatin verifikues prej një viti e gjashtë muaj,** duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, nën kërcënim të revokimit të tij në kuptim të nenit 53 ose 54 të KPRK-s.

II. Të pandehurit në fjalë në kuptim të nenit 69 të KPRK-s lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s i shqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES** duke ju konfiskuar një pistoletë ““ me numër serik ...kalibër ... mm, ...fishekë të kalibrit ...mm dhe ... karikator të zbraztë, sipas aktit të konfiskimit të datës ... nga oficeri policor i Stacionit Policor në Gjilan – me numër të DI ... lidhur me rastin policor ..., të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohen përmes komisionit kompetent me proceverbali përkatës i cili duhet t’i bashkëngjitet kësaj lënde penale, poqese konform dispozitave ligjore të LESP nuk vendoset ndryshe nga personi i autorizuar gjatë ekzekutimit të këtij dënimi plotësues.

III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t’ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **njëzetepesë (25) Euro**, në afat prej tridhjetë (**30**) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – DKR kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore.

Kryetari i trupit gjykues menjëherë pas pranimit të lëndëve penale nga gjyqtari i pensionuar ka kontrolluar lëndët dhe me urdhresë ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar duke i ftuar palët përkatëse.

Pasi që i pandehuri gjatë seances së shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë gjykata pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit por edhe të mbrojtësit të të pandehurit të caktuar sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 paeragrafi 1 të KPP-s, duke e vazhduar seancën me deklaratat e palëve si në vijim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se me rastin e matjes së dënimit dhe lartësisë duhet të marren për bazë rrethanat lehtësuese edhe atë pranimi i singert i fajësisë, rrethanat familjare meqë është prind i pandehuri i tetë fëmijëve dhe faktin se më pare nuk ka qenë i dënuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, por edhe keqardhjen për fgabimin e bërë në rastin konkret.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë, se ka ndioer keqardhje por edhe është penduar për veprën penale, se më pare nuk ka qenë i gjykuar dhe se premtion se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ashtu që këto rrethana duhet trajtuar si rrethana veçanërisht lehtësuese, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të mbrojturit të tij t’i shqiptoj një dënim të butë mundësisht të kushtëzuar me të cilin do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se e mbështet mbrojtjen e theksuar nga mbrojtësi i tij duke u zotuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej këso veprash penale e as të natyrave tjera.

Kryetari i trupit gjykues me qëllim që mos ta mbështesë aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë së të pandehurit, në kuptim të nenit 361 të KPP ka vlerësuar edhe provat tjera në shkresa të lëndës të cilave jua ka falur besimin e plotë dhe ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të gjitha elementet objektive lidhur me veprën penale lëndore nuk janë kontestuese, e këto elemente nuk i ka kundërshtuar as i pandehuri duke e pranuar fajësinë për veprën penale lëndore.

Nuk është kontestues as elementi subjektiv i cili konsiston në dashje direkte meqë i pandehuri e ka ditur se është i ndaluar posedimi i paautorizuar i armës lëndore të sekuestruar dhe se e ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tij inkriminues dhe ka mundur që t'i shmanget një veprimi të tillë të kundërligjshëm.

Sa i përket përgjegjësisë penale gjykata ka vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tij kriminal dhe se ka mundur që veprimet e tilla kriminale t'i kontrollojë duke u përmbajtur nga një veprim i tillë i ndaluar me ligj, andaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri është penalisht i përgjegjshëm për veprën penale lëndore.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar më lart, por edhe elementet objektive dhe subjektive lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri është kryes dhe penalisht përgjegjës për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPK-s, duke e shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të gjykatës për llojin dhe lartësinë e dënimit, janë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-s edhe atë si rrethana lehtësuese ka pasur parasysh : bashkëpunimin e sinqert të të pandehurit me organet shtetërore gjatë gjitha fazave të procedurës, pranimin e fajësisë pa hezitim për veprën penale lëndore, pendimin e sinqert për veprimin e kundërligjshëm të tij, premtimin serioz se në të ardhmen do të përpiqet maksimalisht që mos të bie ndesh me ligjin, gjendjen e varfër ekonomike të tij, moshën e shtyer, se është i pagjykuar dhe se nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, rrethana këto ashtu të bashkuara paraqesinë rrethana veçanërisht lehtësuese në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPP-s, kurse rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Andaj, gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar si dhe rrethanat e lartcekura është e bindur se edhe me një dënim me kusht mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 50 lidhur me nenin 41 të KPRK-s, duke e parandaluar të pandehurin që në të ardhmen mos të kryej vepra penale, duke e resocializuar të njëjtin përmes ngritjes së moralit dhe forcimit të detyrimit për respektimin e ligjit të vendit, por edhe në disiplinimin e qytetarëve potencial që mos të kryejnë vepra penale të kësaj natyre por edhe të ngjashme.

Lidhur me dënimin plotësues gjykata ka vendos në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s, pasi që detyrimisht duhet konfiskuar objektin e veprës penale lëndore, për të cilën është i pandehuri shpallur fajtor dhe dënuar me dënim me kusht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi..

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i krimeve të rënda
Divizioni Penal PKR.nr. 257/2014, më dt. 08 shtator të vitit 2016**

Sekretarja juridike,
gjkues,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit

Aziz Shaqiri

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit.
Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.